



## Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, më 17 korrik, Trupi Gjykses rrëzoi kërkesën e mbrojtësit të viktimave për të pranuar informacion plotësues lidhur me dëmin që u është shkaktuar viktimave pjesëmarrëse në këtë çështje gjyqësore. Trupi Gjykses doli në përfundimin se, në rast se duhet të dorëzohet ky informacion, atëherë ai është objekt i të njëjtave rregulla sikurse për dëshmitë me shkrim të dëshmitarëve. Për rrjedhojë, Trupi Gjykses urdhëroi mbrojtjen e viktimave ta njoftonte deri më 22 korrik nëse synonte ta dorëzonte informacionin lidhur me viktimat në përputhje me rregullat për pranimin e dëshmive me shkrim të dëshmitarëve. Më 22 korrik, mbrojtja e viktimave njoftoi Trupin Gjykses se synonte ta bënte këtë.

Më 18 korrik, u bë publik një vendim i majit të këtij viti për pranimin e provave. Prokuroria kishte kërkuar pranimin e provave me shkrim vetëm për tre dëshmitarë dhe kishte kërkuar leje të shtonte një paragraf të deklaratës së një prej dëshmitarëve në listën e provave materiale. Trupi Gjykses e miratoi mocionin pjesërisht dhe nuk pranoi deklaratën e një prej dëshmitarëve pasi konstatoi se vlera provuese e saj zhbëhej prej efektit dëmtues. Trupi Gjykses theksoi se pesha dhe mbështetshmëria përfundimtare në deklaratat e pranuar do të vlerësohet në fund të gjyimit duke marrë parasysh të gjitha provat, përfshirë parashtrimet e palëve lidhur me to.

Më 21 korrik, Trupi Gjykses rrëzoi një mocion urgjent të Mbrojtjes që kërkonte qasje në versionin konfidencial të Aktgjykimit të Apelit në çështjen *Pjetër Shala*. Meqenëse Paneli i Gjykatës së Apelit është ende i angazhuar me apelin kundër Urdhrit për Zhdëmtim në të njëjtën çështje gjyqësore dhe se procesi në këtë çështje është ende në vazhdimësi para të njëjtit Panel të Gjykatës së Apelit, Trupi Gjykses udhëzoi Mbrojtjen t'ia dorëzonte këtë kërkesë Panelit të Gjykatës së Apelit. Më 24 korrik, Paneli i Apelit miratoi kërkesën dhe u rikujtoi palëve klasifikimin konfidencial të dokumentit.

Më 22 korrik, Trupi Gjykses mbajti konferencë për ecurinë e kësaj çështjeje gjyqësore për të diskutuar me palët hapat vijues në këtë çështje dhe për të dëgjuar prej tyre nëse ka probleme të pazgjidhura që pengojnë hapat vijues në këtë proces.

Seanca filloi me urdhër gojor nga Trupi Gjykses lidhur me mocionin e përbashkët të Mbrojtjes për rrëzimin e akuzave. Trupi Gjykses urdhëroi Mbrojtjen që, ose të kërkonte riklasifikim të mocionit të përbashkët, ose të dorëzonte version të redaktuar publik të tij. Trupi Gjykses po ashtu miratoi kërkesën e Prokurorisë për të riklasifikuar si publike përgjigjen e saj ndaj mocionit të Mbrojtjes.





Gjatë seancës, ekipet e Mbrojtjes njoftuan Trupin Gjykses se mund të mos jenë në gjendje të respektojnë afatet e caktuara nga Trupi Gjykses lidhur me fillimin e paraqitjes së provave të tyre dhe kërkuan të fillojnë me paraqitjen e provave të tyre më 15 shtator. Mbrojtja theksoi se disa prej dëshmitarëve të vet do të flisnin për aspekte që janë të klasifikuara si konfidenciale nga organizata të tjera dhe, përpara se informacioni të nxirret në sallën e gjyqit, duhet të merret autorizim nga ofruesi i informacionit. Gjithashtu, Mbrojtja theksoi se ishte përgatitur për afate të ndryshme diskutuar në fillim të këtij viti dhe për këtë arsye mund të ishte e vështirë për të që të respektonte afatet e caktuara nga Trupi Gjykses në qershor të këtij viti. Trupi Gjykses njoftoi se do të lëshonte vendim me shkrim lidhur me afatet.

Në çështjen *Hashim Thaçi, Bashkim Smakaj, Fadil Fazliu, Isni Kilaj dhe Hajredin Kuçi*, më 21 korrik, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rrëzoi kërkesën e Mbrojtjes së z. Fazliu që Prokuroria t'i kthente telefonin e sekuestruar meqenëse ishte bërë kopje forenzike e telefonit. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujtoi se Prokuroria kishte dorëzuar një raport ku jepte informacion konkret pse duhej të mbahej më gjatë telefoni dhe konstatoi se mbajtja e aparatit fizik ishte e domosdoshme për të kryer hetime forenzike të mëtejshme dhe për të garantuar ruajtjen e provave origjinale për procesin në këtë çështje gjyqësore, përfshirë garantimin e të drejtave të të akuzuarve për gjykim të drejtë për të inspektuar dhe ekzaminuar këtë provë fizike gjatë gjykimit. Gjykatësja e Procedurës Paraprake doli në përfundim se është e nevojshme mbajtja e telefonit deri në përfundim të procesit të kësaj çështjeje gjyqësore.

Më 23 korrik, Trupi Gjykses miratoi pjesërisht kërkesën e Mbrojtjes së z. Thaçi që të lejohej të apelonte rrëzimin e mocionit paraprak prej Gjykatësës së Procedurës Paraprake, lidhur me kundërshtimin e juridiksionit të Dhomave të Specializuara.

Në veçanti, Mbrojtja e Thaçit kundërshtonte vendimin e Gjykatësës së Procedurës Paraprake lidhur me përgjegjësitë e Trupit Gjykses në çështjen për krime lufte *Thaçi dhe të tjerët* përkundërt Gjykatësit të Vetëm, Prokurorisë dhe Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rrëzoi kërkesën për të apeluar këtë pikë, duke theksuar se Prokuroria veproi drejtë që i dorëzoi Gjykatësit të Vetëm kërkesat lidhur me hetimin e pretendimeve për orvatje për ndërhyrje ndaj dëshmitarëve në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët*, pasi Gjykatësi i Vetëm është përgjegjës për trajtimin e çdo kërkesë që kërkon autorizim gjyqësor dhe aspektet përkatëse, para dorëzimit të një aktakuze. Gjykatësja e Procedurës Paraprake theksoi më tej se, pavarësisht se ndërhyrja e pretenduar ndaj dëshmitarëve ka buruar nga çështja për krime lufte, ato janë dy çështje gjyqësore të ndryshme dhe për rrjedhojë Trupi Gjykses në çështjen për krime lufte nuk mund të ushtrojë kompetencat e veta në këtë çështje.

Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjithashtu autorizoi Mbrojtjen e Thaçit t'i paraqiste një paneli të apelit pyetje sesi fakte të shqyrtuara në procese të tjera për krime lufte mund të zbatohen në këtë çështje gjyqësore, pasi konstatoi se ky aspekt mund të ndikojë në mënyrë të qenësishme në rezultatin e gjykimit dhe vlerësoi se ishte e rëndësishme të zgjidhej ky aspekt që në fillim në mënyrë që z. Thaçi të ketë kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur siç duhet për mbrojtjen e tij.





Gjykatësja e Procedurës Paraprake po ashtu e autorizoi Mbrojtjen e Thaçit t'i paraqiste panelit të apelit pyetje nëse Gjykatësja e Procedurës Paraprake duhet të rishikojë detyrat e veta si Gjykatëse e Procedurës Paraprake dhe Gjykatëse e Vetme dhe nëse duhet të lejohet Mbrojtja të kundërshtojë, përmes një mocioni paraprak, praktikën e caktimit të së njëjtës gjykatëse si Gjykatëse e Vetme dhe Gjykatëse e Procedurës Paraprake. Sipas Gjykatëses së Procedurës Paraprake, këto aspekte kanë të bëjnë me të drejtën e z. Thaçi për t'u gjykuar nga një tribunal i pavarur dhe i paanshëm siç garantohet në Kushtetutën e Kosovës dhe Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, kështu që janë pika të apelueshme.

Më 23 korrik, Gjykatësja e Procedurës Paraprake miratoi një kërkesë tjetër të Mbrojtjes së Thaçit që të lejohej të apelonte vendimin e saj të mëparshëm ku rrëzoi kërkesën e Mbrojtjes për të ndarë gjykimin e z. Thaçi nga një prej të bashkakuzuarve dhe që të shtyhej gjykimi i tij në këtë çështje gjyqësore deri pas përfundimit të çështjes gjyqësore kundër tij për krime lufte. Gjykatësja e Procedurës Paraprake është bindur se kjo ka të bëjë me aspektin sesi konstatimet në një çështje gjyqësore do të lidhen me çështjen tjetër dhe për rrjedhojë mund të ndikojë në mënyrë të qenësishme në rezultatin e gjyimit. Ajo konstatoi më tej se zgjidhja e hershme e kësaj pike do të thjeshtonte procesin dhe do të avanconte të drejtat e të akuzuarve për t'u gjykuar në kohë të arsyeshme.

Ky është informimi i fundit për shtyp para pushimit veror të Gjykatës, që zgjat nga 27 korriku deri më 15 gusht. Gjatë kësaj periudhe nuk do të ketë seanca, sidoqoftë puna në Gjykatë do të vijojë pa ndërprerje. Informimi vijues për shtyp i DHSK-së do të mbahet më 21 gusht në orën 2:30 të pasdites.

